

Të nderuar të pranishëm,

Kam kënaqësinë që jam pjesë e kësaj tryeze për të diskutuar mbi zhvillimet ekonomike që kanë karakterizuar vendin tonë në dekadën e parë si shtet i pavarur, si dhe për të diskutuar mbi rrugën që e kemi përpara për ta forcuar zhvillimin ekonomik dhe për ta ngritur nivelin e mirëqenies së qytetarëve tanë.

Të gjithë ne në këtë panel përfaqësojmë shtylla shumë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të vendit dhe me shumë siguri mund të them se, përkundër sfidave të vazhdueshme, secili nga ne ka për të treguar një tregim të suksesshëm të progresit ekonomik të vendit dhe një vizion të qartë se si duhet t'i adresojmë sfidat që na presin.

Në vitet e para të pavarësisë, kur Kosova pritej që ta ketë hovin më të madh të zhvillimit ekonomik, ekonomia globale u zhyt në krizën më të madhe ekonomike që nga Depresioni i Madh, gjë e cila ndikoi negativisht në prospektet ekonomike të Kosovës. Megjithatë, Kosova gjatë këtyre 10 viteve arriti të mirëmbajë një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe një shkallë të lartë të stabilitetit makroekonomik, duke dëshmuar se jemi një vend me perspektivë të mirë ekonomike dhe me potencial për të gjeneruar zhvillim dhe stabilitet makroekonomik.

Njëra nga shtyllat më të rëndësishme të rrugëtimit të ekonomisë së vendit gjatë këtij dhjetë vjeçari pa dyshim se është sistemi financiar i vendit, i cili u zhvillua në një sektor që në mënyrë shumë efektive po i ofron ekonomisë shërbime bashkëkohore financiare dhe në të njëjtën kohë, është shndërruar në një burim shumë të rëndësishëm të stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik të vendit.

Spektori bankar i Kosovës, i cili në kohën e shpalljes së pavarësisë së vendit kishte filluar të përshpejtojë ritmin e rritjes së kreditimit, gjatë këtyre 10 viteve u shndërrua në njërin ndër burimet kryesore të financimit të ekonomisë së vendit, duke i rezistuar madje edhe rrethanave më të pafavorshme gjatë periudhës së krizës globale. Përderisa në muajin shkurt 2008 vlera e përgjithshme e kredive bankare ishte 937 milionë euro, aktualisht vlera e tyre ka arritur në rreth 2.5 miliardë euro, gjë e cila flet për një rritje të konsiderueshme të shkallës së ndërmjetësimit financiar në vend. Pjesa dërmuese e këtyre kredive i janë lëshuar bizneseve, përderisa burimi

kryesor i financimit të tyre janë depozitat e mbledhura nga ekonomitë familjare, gjë e cila flet për një kanalizim shumë të rëndësishëm të këtyre mjeteve nga kursyesit drejt investitorëve.

Kreditimi bankar, përveçse u karakterizua me rritje të qëndrueshme, në vazhdimësi regjistroi edhe përmirësim të kushteve të financimit për bizneset dhe ekonomitë familjare, duke e fuqizuar kështu edhe më tutje rolin e tij në financimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Me këtë rast, dëshiroj të potencoj rënien substanciale të normave të interesit në kreditë bankare, të cilat tanimë kanë zbritur në nivelin e mesatares së rajonit, duke nxitur kështu kërkesën për kredi dhe duke mundësuar realizimin e shumë projekteve investive të cilat nuk do të mund të ndodhnin pa financimin bankar. Aktualisht, norma mesatare e interesit në kredi qëndron në 6.8 përqind, krahasuar me normën mesatare prej 14.3 përqind në kohën e shpalljes së pavarësisë së vendit.

Rënia e normës së interesit gjatë kësaj periudhe pasqyron më së miri rezultatet që mund të arrihen përmes zhvillimit të shëndoshë institucional dhe bashkëveprimit ndërmjet të gjithë akterëve relevantë për të ofruar një ambient më të favorshëm për zhvillimin e biznesit. Politika e kujdesshme rregulluese, licencuese dhe mbikëqyrëse e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në bashkëveprim me sjelljen e përgjegjshme të institucioneve bankare që operojnë në Kosovë, ka krijuar kushtet që në tregun bankar të vendit të zhvillohet një konkurrencë e shëndoshë, e cila po i sjellë ekonomisë të gjitha përfitimet e një tregu konkurrues. Po ashtu, bashkëpunimi efektiv ndërmjet BQK-së dhe autoriteteve të drejtësisë në vend ka mundësuar përmirësim substancial në rritjen e efikasitetit të zbatimit të kontratave për sistemin financiar, duke çuar kështu në zvogëlimin e rrezikut për bankat dhe rrjedhimisht rënie të normave të interesit.

Për të mbështetur zhvillimin e një sektori financiar sa më efikas, BQK-ja në vazhdimësi është angazhuar në zhvillimin dhe avancimin e infrastrukturës që i ofron institucioneve financiare që operojnë në Kosovë. Në këtë kontekst, dëshiroj të potencoj se, pavarësisht se jemi vendi më i ri në rajon, ne sot kemi në përdorim versionet më të avancuara të sistemit të pagesave ndërbankare dhe të regjistrimit të kredive, të cilat paraqesin komponente shumë të rëndësishme të infrastrukturës financiare dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në qasjen në financa, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Se Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në fushën e qasjes në financa, e konfirmon edhe Raporti i të Bërit Biznes i Bankës Botërore, ku kriteri i qasjes në financa e radhitë Kosovën në mesin e vendeve më të avancuara në botë.

Përveç kontributit në financimin e aktivitetit ekonomik, sektori bankar paraqet një shtyllë shumë të rëndësishëm edhe të stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik të vendit në saje të treguesve që e radhitin Kosovën në mesin e vendeve me sektorët më të qëndrueshëm bankar. Me këtë rast do të përmend vetëm treguesin e kredive joperformuese prej 3.1 përqind, i cili mjafton për të treguar shëndetin shumë të mirë që gëzon sektori bankar i Kosovës.

Zhvillime të ngjashme pozitive kanë karakterizuar edhe komponentët e tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe atyre financiare jobankare po fuqizon çdo ditë e më tepër rolin e tij në financimin e ekonomisë së vendit përmes mikrokredive. Sistemi pensional me sukses po arrin të menaxhojë kursimet pensionale të qytetarëve të Kosovës, duke shtuar vlerën e këtyre kursimeve përmes politikave të kujdesshme të investimit të këtyre mjeteve në tregun vendor dhe në tregjet financiare ndërkombëtare. Sektori i kompanive të sigurimit, aktiviteti i të cilit kryesisht po bazohet në ofrimin e produkteve të sigurimit të detyrueshëm, çdo ditë e më tepër po e rrit aktivitetin në fushën e sigurimeve vullnetare të cilat janë shumë të rëndësishme për zvogëlimin e rrezikut dhe rritjen e aktivitetit në ekonominë e vendit. Po ashtu, brishtësitë financiare që e kanë karakterizuar këtë sektor tani më kanë filluar të adresohen në mënyrë efektive dhe brenda një të ardhme shumë të afërt ato do të jenë plotësisht të tejkaluara.

Me gjithë zhvillimet pozitive që ka shënuar ekonomia jonë përgjatë dekadës së parë të pavarësisë së vendit, ne jemi të vetëdijshëm se duhet ende shumë për të bërë për të rritur zhvillimin ekonomik dhe për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve tanë. Papunësia dhe deficitin tregtar vazhdojnë të përfaqësojnë sfida shumë të rëndësishme për ekonominë tonë dhe kërkojnë të punojmë edhe më intenzivisht dhe më bashkërisht për t'i adresuar ato.

Adresimi i këtyre sfidave në radhë të parë kërkon rritje të prodhimit vendor dhe konkurrueshmëri më të madhe të produkteve tona në tregjet ndërkombëtare. Për t'i arritur këto, në mesin e shumë sfidave tjera, pa dyshim se gjendet edhe sfida për t'i siguruar biznesit një qasje edhe më të madhe dhe me kushte edhe më të favorshme në financimin e jashtëm.

Mundësitë aktuale të bizneseve që operojnë në Kosovë për t'u qasur në burime të jashtme të financimit janë të kufizuara pothuajse vetëm në kredi, përderisa tregu i kapitalit mbetet ende i pazhvilluar. Ne jemi të vetëdijshëm se për një vend të vogël si Kosova, me një ekonomi jo mjaft të zhvilluar, është e vështirë të zhvillojmë një treg funksional të kapitalit siç është bursa. Megjithatë, nevojitet që të gjithë bashkërisht të punojmë më tepër në drejtim të shqyrtimit të mundësive të bashkëpunimit rajonal për sa i përket tregut të kapitalit në mënyrë që t'i sigurojmë kompanive tona qasje në këto tregje si mënyrë për të përfituar nga diversifikimi i burimeve të financimit.

Përderisa mbetet sfidë mjaft e rëndësishme zhvillimi i tregut të kapitalit, sfidat janë të pranishme edhe për sa i përket fuqizimit të mëtejshëm të rolit të kreditimit bankar në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit. Me gjithë rritje e qëndrueshme që ka shënuar kreditimi gjatë gjithë periudhës së funksionimit të sektorit bankar të Kosovës, në raport me madhësinë e ekonomisë mbetet ende hapësirë e konsiderueshme për rritje të kredive.

Përmes politikës së hapur por të kujdesshme të licencimit si dhe përmes avancimit të mëtejshëm të infrastrukturës financiare, BQK-ja po përpiqet të krijojë kushtet për zhvillim të mëtejshëm të konkurrencës në tregun bankar të vendit, duke tërhequr interesimin e bankave me renome ndërkombëtare për të ardhur në tregun tonë si dhe duke i mundësuar bankave ekzistuese zhvillim të mëtejshëm. E tërë kjo do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e mëtejshme të ofertës kreditore dhe do të përmirësojë edhe më tutje kushtet e kreditimit.

Përveç rritjes së vëllimit të kredive, sfidë e rëndësishme mbetet edhe nevoja për një diversifikim më të madh të kredive bankare përgjatë sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Aktualisht mbi gjysma e kredive bankare janë të lëshuara për sektorin e tregtisë, ndërsa sektorët që mund të prodhojnë një vlerë mjaft të madhe të shtuar për ekonominë siç janë bujqësia dhe prodhimtaria vazhdojnë ta kenë një qasje relativisht të ulët në kreditimin bankar. Mirëpo, kjo strukturë e kredive bankare në radhë të parë pasqyron vetë strukturën e ekonomisë së Kosovës e cila dominohet nga ndërmarrjet tregtare, gjë që nënkupton se rrugën e adresimit të kësaj sfide nuk duhet ta kërkojmë vetëm në anën e ofertës kreditore, por para se gjithash në anën e kërkesës për kredi. Me fjalë të tjera, kërkohet një bashkëpunim gjithëpërfshirës institucional për të ndihmuar në rimëkëmbjen e këtyre sektorëve me qasje më të ulët në kreditimin bankar në mënyrë që ata të bëhen të aftë për të gjeneruar kërkesë për kredi.

Po ashtu, me gjithë përmirësimin shumë të dukshëm gjatë viteve të fundit, zvogëlimi i mëtejme i kostos së financimit bankar mbetet një sfidë e vazhdueshme. Angazhimi jonë për të krijuar kushtet për zhvillimin e mëtejme të konkurrencës së shëndoshë në tregun bankar dhe për të avancuar infrastrukturën financiare, së bashku me aktivitetet e bankave për të adoptuar teknologji moderne, si dhe angazhimet e të gjitha institucioneve për të përmirësuar edhe më tutje ambientin afarist në Kosovë, jam shumë i sigurt se do të rezultojnë në rritje të mëtejme të konkurrencës dhe të efikasitetit në sektorin bankar, duke kontribuar kështu në zvogëlimin e mëtejme të normave të interesit në kredi.

Në përmbyllje të diskutimit tim, dëshiroj të ritheksoj se gjatë dekadës së parë si shtet i pavarur Kosova ka arritur të dëshmojë se ka një ekonomi të aftë për të gjeneruar rritje dhe stabilitet makroekonomik, por se mbeten ende sfida të rëndësishme para nesh për ta bërë Kosovën një më të zhvilluar, dhe për ta arritur këtë kërkohet që të vazhdojmë punën me intensitet edhe më të madh. Përderisa 10 vjeçari i parë si shtet i pavarur ka qenë i dominuar nga temat e lidhura me shtetformimin, tani konsideroj se ka ardhur koha që të orientohemi më tepër në temat që çojnë drejt një zhvillimi më të hovshëm ekonomik. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka ndërtuar kapacitete bashkëkohore dhe është e gatshme për t'u ballafaquar me të gjitha sfidat në fushëveprimin e saj për ta mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit.